



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1281/13 prot

Datë 15.09.2021

V E N D I M

K.P.P.633/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.09.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-95477-05-14-2021, me objekt: “*Rehabilitim i Rrugës së Rrodokalit, Njësia administrative Proptisht*”, me fond limit 58,333,330 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 08.06.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Infini” SHPK & “Sireta 2F” SHPK.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Rej” SHPK

Adresa: Lagjja nr.3, Shëtitore “Europa”, Pogradec.

- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Pogradec
Adresa: Lagjja nr. 2, Blv. "Reshit Çollaku", Pogradec.
- Subjekte të interesuara:** BOE "Infinit" SHPK & "Sireta – 2F" SHPK
Adresa: Lagjja nr. 2, Rr. "Rinia", P. 136, Shk. 1, Ap. 12, Pogradec.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik" , Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

- I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".
- I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.
- I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".
- I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.05.2021, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-95477-05-14-2021, me objekt: “*Rehabilitim i Rrugës së Rrodokalit, Njësia administrative Proptisht*”, me fond limit 58,333,330 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 08.06.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.

II.2. Në datën 08.06.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 29.06.2021, ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave përkatësisht:

“Company Riviera 2008”	32, 192,003 lekë	skualifikuar
BOE “Infinit”&”Sireta-2F”	41,760,122 lekë	kualifikuar
“Leon Konstruksion”	49,555,556.46 lekë	skualifikuar
BOE “Eurondërtim 2000” & ”Almo Konstruksion”	53,100,940.10 lekë	skualifikuar
“Rej”	54,104,630 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 29.06.2021 operatori ekonomik “Rej” SHPK është njoftuar elektronikisht për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, sipas argumentimi/arsyetimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, si më poshtë vijon:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ”Rej” SHPK me Nipt: J93711608Q me vlerën e ofertës : 54 104 630 (pesëdhjetë e katër milion njëqind e katër mijë e gjashtëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH, rezultoi se dokumentacioni i paraqitur nuk është në përputhje me kriteret e vendosura në DST, me ndryshimet përkatëse.

1. Mungon ISO 9001, konkretisht kësaj ISO-je nuk i është bërë mbikqyrje vjetore e cila është kusht për vlefshmërinë e certifikatës.

2. Mungon ISO 99:2012, konkretisht kësaj ISO-je nuk i është bërë mbikqyrje vjetore e cila është kusht për vlefshmërinë e certifikatës.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 77 të ligjit 162/2020 “Kërkesat për kualifikim”, .”Rej” shpk me Nipt: J93711608Q me vlerën e ofertës : 54 104 630 (pesëdhjetë e katër milion njëqind e katër mijë e gjashtëqind e tridhjetë),lekë pa tvsh, nuk kualifikohet.

II.5. Në datën 05.07.2021 është publikuar njoftimi i fituesit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike si dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 109, më datë 12.07.2021.

II.6. Në datën 08.07.2021, operatori ekonomik ankimues “Rej” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Rej” SHPK, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Infini” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1281/2 date 09.07.2021 lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Rej” SHPK, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Infini” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.8. Me shkresën nr. 1281/3 prot., datë 13.07.2021, operatori ekonomik “infini” SHPK në cilësinë e operatorit ekonomik, i cili ka interes në këtë procedurë prokurimi, ka vënë në dijeni Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me argumentet (kleime) në lidhje me ankesën me nr. REF-95477-05-14-2021.

II.9. Në përfundim të afatit 10 ditor brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën nr. 1281/4 prot., datë 21.07.2021, i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, të jepet informacion i hollësishëm, vërtetuar me dokumentacion, për depozitimin e ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe trajtimin e saj, si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Rej” SHPK.

II.10. Me shkresat me nr. 3175/6 prot., datë 21.07.2021 dhe me nr. 3175/8 prot., datë 27.07.2021 protokolluar me tonën respektivisht me nr. 1281/5 prot., datë 26.07.2021 dhe nr. 1281/6 prot., datë 29.07.2021, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatorit ekonomik “Rej” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.11. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK dhe me shkresën nr. 3175/4 prot., datë 19.07.2021, e

ka njoftuar atë, se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës. Konkretisht ankimuesi në ankesën e paraqitur, ngre pretendime mbi skualifikimin e ofertës së tij, si dhe kualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Infinit” SHPK & “Sireta - 2F” SHPK. Në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka pranuar pjesërisht ankesën, vetëm lidhur me pretendimet për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK.

II.12. Me shkresën nr. 1281/7 prot., datë 30.07.2021 me lëndë “Kërkesë për informacion” drejtuar operatorit ekonomik “Rej” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik ka kërkuar nga ankimuesi të dorëzojë pranë KPP dokumentacion të nevojshëm në cilësinë e provës, për të vërtetuar marrjen dijeni mbi Njoftimin e Fituesit, brenda orarit zyrtar të datës 02.08.2021.

II.13. Me shkresën nr. 81 prot., datë 31.07.2021 protokolluar me tonën me nr. 1281/8 prot., datë 03.08.2021 me lëndë “Kthim-përgjigjeje”, operatori ekonomik “Rej” SHPK ka dërguar print screen e SPE të rubrikës mesazhe dhe Komisioni konstatoi se, operatori ekonomik ankimues nuk ka marrë dijeni mbi Njoftimin e Fituesit.

II.14. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin 444/2021, datë 04.08.2021 ka vendosur:

1. *Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit me “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-95477-05-14-2021, me objekt: “Rehabilitim i Rrugës së Rrodokalit, Njësia administrative Proptisht”, me fond limit 58,333,330 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 08.06.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.*
2. *Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.*
3. *Kopje e këtij vendimi të dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.15. Me shkresën nr. 1281/10 prot., datë 03.09.2021 Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua shoqërisë “Simaku” SHPK, me anë të së cilës ka kërkuar informacion për kontratën e furnizimit e lidhur më datë 07.06.2021, nëse është nënshkruar me vulë dhe firmë nga shoqëria “Simaku” SHPK.

II.16. Me shkresën protokolluar me tonën me nr. 1281/12 prot., datë 14.09.2021 me lëndë “Kthim-përgjigjeje” sipas së cilës, shoqëria “Simaku” SHPK ka konfirmuar nënshkrimin e kontratës së furnizimit e lidhur më datë 07.06.2021.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur prej bashkimit të operatorëve ekonomikë “Infinit” SHPK dhe “Sireta-2F” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen : “[...]Si rrjedhojë, çmujmë se operatori ekonomik “Infinit” SHPK, pjesëmarrës në procedurën objekt-ankimimi është kualifikuar në mënyrë të padrejtë nga KVO, pasi nuk përmbush kriteret në DST dhe ka paraqitur dokumente të parregullta. Në DST pika 2.3.8 është kërkuar:

2.3.8 Operatori ekonomik të ketë në pronësi ose me qira mjete dhe makineri si më poshtë:

5	Autobitumatriçe	Copë 1	në pronësi ose me qira
---	-----------------	--------	------------------------

23	Fabrikë Asfalti pajisur me leje mjedisore	Copë 1	në pronësi, me qira ose me kontratë furnizimi
----	---	--------	---

Në dijeninë tonë gjykojmë se operatori ekonomik “Infinit” SHPK ka paraqitur kontratë qiraje të pavlefshme për automjetin autobitumatriçe dhe kontratë furnizimi me asfalt me shoqërinë “Simaku” SHPK, e cila referuar një kërkimi në faqen zyrtare të QKB-së rezulton me administrator Z. Thoma Simaku. Duke qenë se kemi një eksperiencë shumë të gjatë disavjeçare në fushën e ndërtimit, kemi dyshime të arsyeshme, që këto dy kontrata janë të parregullta, pasi dyshojmë se nuk janë firmosur nga subjekti Simaku SHPK, pasi mjetet e mësipërme janë të angazhuara nga kjo shoqëri në aktivitetin e përditshëm të fundit të kësaj të mësipërme. Kërkojmë nga AK verifikimin e këtyre kontratave pasi dyshojmë, që firma dhe vula e shoqërisë Simaku SHPK nuk janë autentike dhe janë të fallsifikuara”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.8 tek kapaciteti teknik, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.8 Operatori ekonomik të ketë në pronësi ose me qira mjete dhe makineri si më poshtë:

5	Autobitumatriçe	Copë 1	në pronësi ose me qira
---	-----------------	--------	------------------------

• Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e mjetit:

- certifikatën e pronësisë;

-leja e qarkullimit;

-certifikatën e kontrollit teknik;

- siguracionin;

- leja e transportit që lëshohet nga njësia vendore;

ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve.

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë mbi vendodhjen e mjeteve.
- Për fabrikën e betonit / asfaltit, në rast se është në pronësi duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e saj dhe Leja mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit.
- Në rast se fabrika e betonit/ asfaltit është me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë e shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pronësinë e saj dhe Lejen mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit.
- Në rast se fabrika e betonit / asfaltit, nuk është në pronësi ose me qira të paraqitet një aktmarrëveshje / kontratë furnizimi me furnizuesin ku të pasqyrohet periudha e furnizimit. Kjo aktmarrëveshje duhet shoqëruar dhe me dokumentat e pronësisë si dhe me Lejen mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit.
- Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administrator i shoqërisë ofertuese).

Në shtojcën 1 të datës, 24.05.2021, pika 2.3.8

ISHTE:

- Në rast se fabrika e betonit / asfaltit, nuk është në pronësi ose me qira të paraqitet një aktmarrëveshje / kontratë furnizimi me furnizuesin ku të pasqyrohet periudha e furnizimit. Kjo aktmarrëveshje duhet shoqëruar dhe me dokumentat e pronësisë si dhe me Lejen mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit.

BËHET:

- Në rast se fabrika e betonit / asfaltit, nuk është në pronësi ose me qira të paraqitet një aktmarrëveshje / kontratë furnizimi me furnizuesin ku të pasqyrohet periudha e furnizimit. Kjo aktmarrëveshje duhet shoqëruar me dokumentat e pronësisë dhe dokumentacion që provon se fabrika është e pajisur me QKL.

23	Fabrikë Asfalti pajisur me QKL	Copë 1	në pronësi, me qira ose me kontratë furnizimi
----	--------------------------------	--------	---

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Infinit” SHPK & “Sireta 2-F” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, kanë dorëzuar: Konkretisht për shoqërinë “Infinit” SHPK:

- Shtojcën 10, “Mbi disponimin e makinerive” nga operatori ekonomik “Infinit” SHPK.
- Kontratë qiraje ndërmjet shoqërisë “Simaku” SHPK dhe “Infinit” SHPK, për mjetin “autobitumatriçe” me targa KO6730B, shasia 35205710698452, shoqëruar me vërtetim nënshkrimi në akte të ndryshme ose në deklarata personale me Nr. 824 Rep., më datë 07.06.2021, në prani të noterës B. S., anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega vendore Korçë, me zyrë në adresën Pogradec, nr. 2, Naim Frashëri, nr. 8.
- Kontratë furnizimi e lidhur më datë 07.06.2021, midis porositësit “Infinit” SHPK dhe furnizuesit “Simaku” SHPK, me objekt: *“Kontratë e furnizimit për asfalt në objektin: "Rehabilitim i rrugës së Rrodokalit, Njësia Administrative Proptisht".*

III.1.4. Në nenin 77, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.1.5. Në nenin 39, pika 4 dhe gërma “d” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: *“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të*

lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.[...]”

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.1.7. Në lidhje me pretendimin e ankimesit për vërtetësinë e kontratës së qirasë për mjetin “autobitumatriçe” me targa KO6730B, Komisioni Prokurimit Publik konstaton, se sipas kriterit të kualifikimit për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të kërkuar për mjetin, duhet të paraqitet edhe **kontrata e qirasë**, e cila dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), shoqëria “Infinit” SHPK ka dorëzuar kontratë qiraje ndërmjet palëve të cilat janë shoqëria “Simaku” SHPK dhe shoqëria “Infinit” SHPK, për mjetin “autobitumatriçe” me targa KO6730B, shasia 35205710698452, shoqëruar me vërtetim nënshkrimi në akte të ndryshme ose në deklaratat personale me Nr. 824 Rep., më datë 07.06.2021, në prani të noterit B. S., anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega vendore Korçë, me zyrë në adresën Pogradec, nr. 2, Naim Frashëri, nr. 8.

Referuar nenit 3 “Përkufizime”, gërma “ë” të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, parashikohet se: *“Veprimtari noteriale” janë veprimet e kryera në ushtrim të profesionit të noterit dhe që përfshijnë përgatitjen, hartimin dhe njësimin e akteve juridike, si dhe çdo veprimtari tjetër brenda kompetencës së noterit, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe të ligjeve të veçanta”.*

Në nenin 62 “Kompetencat e noterit” të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, parashikohet se: *“1. Noteri, përveç kompetencave të parashikuara në ligje të veçanta, harton akte, kryen njësimë, vërtetime dhe verifikime në të gjitha çështjet, duke përfshirë, por pa u kufizuar: ë) legalizon nënshkrimet e shtetasve të vëna në dokumente të ndryshme;*

Në nenin 99 “Mënyrat e hartimit të akteve noteriale” të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, parashikohet se: *“1. Aktet noteriale hartohen në bazë të vullnetit të lirë, të plotë dhe të pavesuar të palëve pjesëmarrëse në aktin noterial, si dhe referuar qëllimit që synon të rregullojë dhe/ose të sjellë akti noterial. Aktet noteriale hartohen pastër, qartë dhe në mënyrë që të mos lënë vend për moskuptime ose keqinterpretime.*

Në nenin 106 “Regjistrimi i akteve dhe veprimeve noteriale” të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, parashikohet se: *“1. Akti noterial, i hartuar nga noteri, regjistrohet me numër repertori dhe numër koleksioni ndërsa veprimi noterial regjistrohet vetëm me numër repertori. Çdo akt dhe veprim noterial merr nga sistemi elektronik një numër unik elektronik”.*

Në nenin 128 “Vërtetimi i nënshkrimeve” të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, parashikohet se: *“Vërtetimi i nënshkrimeve bëhet për akte private që nuk përmbajnë lidhjen e një kontrate ose kryerjen e një veprimi tjetër juridik. Vërtetimi bëhet në fund të aktit, pas nënshkrimeve, duke u bërë shënimi nga noteri se personat u paraqitën personalisht dhe nënshkruan në prani të tij ose pranuan se nënshkrimet janë të tyre”.*

Në rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumentit të kontratës së qirasë, KPP konstaton, se ai përmban nënshkrimet e palëve në kontratë. Ky dokument është i shoqëruar me vërtetim nënshkrimi në përputhje me nenin 128 të ligjit “Për noterinë”, si dhe i legalizuar nga noteri në kuptim të nënit 62 të ligjit të këtij ligji. Në këtë kuptim Komisioni gjykon, se dokumenti kontratë-qiraje i paraqitur në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, i regjistruar me numër repertori 824 të datës 07.06.2021, është përpiluar sipas legjislacionit për noterinë në fuqi si dhe është nënshkruar me vullnet të lirë dhe të plotë nga palët, shoqëria “Simaku” SHPK dhe shoqëria “Infinit” SHPK, të cilët paraqitën dhe kanë nënshkruar përpara noteres Znj. B. S., kontratën e qirasë për mjetin me targë KO6730B. Në përfundim të analizës së fakteve të sipërcituara, Komisioni gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Infinit” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, është në përputhje me formën e kërkuar sipas kërkesave të veçanta të kualifikimit, të hartuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.1.8. Në lidhje me pretendimin e ankimuesit për vërtetësinë e kontratës së qirasë për kontratën e furnizimit me asfalt me shoqërinë “Simaku” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se sipas kriterit të kualifikimit ku: *“Në rast se fabrika e betonit / asfaltit, nuk është në pronësi ose me qira të paraqitet një aktmarrëveshje / kontratë furnizimi me furnizuesin ku të pasqyrohet periudha e furnizimit. Kjo aktmarrëveshje duhet shoqëruar me dokumentet e pronësisë dhe dokumentacion, që provon se fabrika është e pajisur me QKL”,* shoqëria “Infinit” SHPK ka

paraqitur kontratë furnizimi e lidhur më datë 07.06.2021, midis porositësit “Infinit” SHPK dhe furnizuesit “Simaku” SHPK, me objekt: *“Kontratë e furnizimit për asfalt në objektin: “Rehabilitim i rrugës së Rrodokalit, Njësia Administrative Proptisht”.*

Kjo kontratë furnizimi, është e nënshkruar nga palët kontraktuese, konkretisht nga administratorët respektivë, Z. K. B, për shoqërinë “Infiniti” SHPK dhe Z. Th. S, për shoqërinë “Simaku” SHPK. Në lidhje me këtë kontratë furnizimi, është ngritur pretendimi, që firma dhe vula e shoqërisë “Simaku” SHPK, nuk është autentike.

Komisioni i Prokurimit Publik, referuar nenit 115, pika 5 e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ka kërkuar informacion për kontratën e bashkëpunimit të sipërcituar, nëse është nënshkruar me vulë dhe firmë nga shoqëria “Simaku” SHPK, me anë të shkresës nr. 1281/10 prot., datë 03.09.2021. Me shkresën protokolluar me tonën me nr. 1281/12 prot., datë 14.09.2021 me lëndë “Kthim-përgjigjeje” sipas së cilës, shoqëria “Simaku” SHPK ka deklaruar se *“Në përgjigje të kërkesës suaj me nr. Prot., 1281/10, datë 03.09.2021 për të cilën jam vënë në dijeni në datë 13.09.2021 brenda afatit prej 5 ditësh po ju bëj me dije se: Lidhur me pretendimin se në ankesën për procedurën me nr. REF-95477-05-14-2021 me objekt: “Rehabilitim i rrugës së Rrodokalit, Njësia administrative Proptisht, kam nënshkruar me vullnetin tim të lirë dhe të pakushtëzuar kontratë furnizimi për asfaltin që mban datën 07.06.2021”.*

Për sa më lart shpjeguar, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur prej bashkimit të operatorëve ekonomikë “Infinit” SHPK dhe “Sireta-2F” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen: *“[...]Ky operator ekonomik nuk plotëson kriteret në DST, konkretisht pikën 2.3.9 ku kërkohet:*

2.3.9 Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me licencat/lejet të lëshuara nga QKL me kod III.2.B (Grumbullim dhe transportim të mbetjeve), dhe III.1.B (Magazininim i mbetjeve).

Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur Lejen e Mjedisit III.1.B (Magazininim i mbetjeve), pasi ky operator ekonomik nuk e disponon një leje të tillë. Nga verifikimi i kryer në website zyrtar të QKB të lëshimit të lejeve të mjedisit rezulton se ky operator ekonomik nuk disponon këtë leje mjedisi të kërkuar dhe duhet skualifikuar, pasi nuk përmbush pikërisht kriterin e përcaktuar në DST e konkretisht pikën 2.3.9”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1 Në shtojcën 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.8 tek kapaciteti teknik, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.9 Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me licencat/lejet të lëshuara nga QKL me kod III.2.B (Grumbullim dhe transportim të mbetjeve), dhe III.1.B (Magazininim i mbetjeve).

III.2.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Infinit” SHPK & “Sireta 2-F” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, kanë dorëzuar: Konkretisht për shoqërinë “Infinit” SHPK:

-Leje me kodin III.1.B në emër të shoqërisë”Infinit” SHPK.

III.2.4. Në nenin 77, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.5 Në nenin 39, pika 4 dhe gërma “a” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose.[...]

III.2.6 Në shtojcën 1 të ligjit nr. 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “për lejet e mjedisit”, të ndryshuar parashikohet se:

Shtojca 1

Lejet e mjedisit të tipave A dhe B, në varësi të kapacitetit prodhues kufi

Kur një operator kryen veprimtari të ndryshme nën të njëjtin nëntitull, si më poshtë, dhe në të njëjtin instalim ose në të njëjtën vendndodhje, kapacitetet e këtyre veprimtarive mbledhen bashkë. N.q.s. nuk përcaktohet ndryshe, në tabelën e mëposhtme, kapaciteti **kufi** nënkupton kapacitetin e plotë prodhues të asaj veprimtarie, pavarësisht nga fakti, nëse ai shfrytëzohet plotësisht apo jo.

	ID	Veprimtaria	Kapaciteti kufi për lejet e tipit A	Kapaciteti kufi për lejet e tipit B
Menaxhimi i mbetjeve	5.1	a. Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incinerimi.	Të gjitha instalimet.	
		b. Incinerimi i mbetjeve urbane jo të rrezikshme.	Të gjitha instalimet.	
		c. Incinerim i mbetjeve duke përfshirë mbetjet e kafshëve në një instalim incinerimi, përveç atij të referuar në pikën 5.1 a	Instalimi i incinerimit përdoret ose është dizenuar për të djegur mbetje me intensitet më shumë se 1 ton/orë.	Instalimi i incinerimit përdoret ose është dizenuar për të djegur mbetje me intensitet të barabartë me 1 ton/orë ose më pak se kaq.
	5.2	a. Lendfilli i mbetjeve (D1) duke përjashtuar lendfillin e mbetjeve inerte.	Kapaciteti i depozitimit është më i madh se 10ton/ditë ose kapaciteti i dizenuar i lendfillit është më i madh se 25000 tonë.	Kapaciteti depozitues është i barabartë me 10ton/ditë ose më pak se kaq ose kapaciteti i dizenuar i lendfillit është 25000 tonë ose më pak se kaq.

	b. Lendfill i mbetjeve inerte.		Të gjitha instalimet.
5.3	a. Asgjësimi i mbetjeve tërrezikshme përveç incinerimit (5.1.a) ose lendfillimit (5.2 a).	Kapaciteti i përpunimit është më i madh se 10 ton/ditë.	Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 10 ton/ditë ose më pak se kaq.
	b. Asgjësimi i vajrave të përdorur përveç incinerimit(5.1 a) ose lendfillimit (5.2.a).	Kapaciteti i përpunimit është me i madh se 10 ton/ditë.	Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 10 ton/ditë, ose më pak se kaq.
	c. Asgjësim i mbetjeve jo tërrezikshme me trajtim biologjik (D8).	Kapaciteti përpunimit është më i madh se 10ton/ditë.	Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 50 ton/ditë ose më pak se kaq.
	d. Asgjësim i mbetjeve jo tërrezikshme me trajtim fiziko – kimik (D9).	Kapaciteti i përpunimit është më i madh se 50 ton/ditë.	Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 50 ton/ditë ose më pak se kaq.
	e. Asgjësimi i mbetjeve jo tërrezikshme me metoda të tjera përveç (D1), (D8) ose (D9).		Të gjitha instalimet.
5.4	a. Rikuperim i mbetjeve tërrezikshme me anë të operacioneve R1, R5, R6, R8, ose R9.	Të gjitha instalimet.	
	b. Rikuperim i mbetjeve tërrezikshme me anë të operacioneve R2, R3, R4, R7 ose R10.		Të gjitha instalimet.
	c. Rikuperim i mbetjeve jo tërrezikshme		Të gjitha instalimet.
5.5	Magazininim i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme.		Kapaciteti i barabarte me 50 ton/ditë ose

			më i madh se kaq.
5.6	a. Pastrim, larje sprucim oseveshje e mbetjeve të ambalazheve/ paketimeve ose kontejnerëve në mënyrë që të ripërdoren.		Kapaciteti i barabartë me 50 ton/ditë ose më i madh se kaq.
	b. Magazinim i mbetjeve në lidhje me zbatimin e veprimtarive të pikës 5.6 a.		Kapaciteti i barabartë me 50 ton/dite ose më i madh se kaq.
5.7	Magazinim, trajtim, riparim ose rinovim i mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike (WEEE).		Të gjitha instalimet.
5.8	Magazinim, rikuperim i hekurishteve/ skrapeve të metalit ose çmontim i mbetjeve nga motorët e makinave.		Të gjitha instalimet.
5.9	Magazinim i përkohshëm i mbetjeve duke përfshirë tepricat e produkteve nga kontejnerët ose nga larjet e kontejnerëve, dhe çdo mbetje të rrezikshme në mjediset pritëse të një zone portuale dhe ku mbetjet janë magazinuar për jo më shumë se 7 ditë.		Të gjitha instalimet.
5.10	a. Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lart.		Të gjitha instalimet.
	b. Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart.		Kapaciteti i barabartë me 50 ton/ditë ose më i madh se kaq.
5.11	Kompostim i mbetjeve bio.		Kapaciteti i kompostimit më i madh

				se 50 ton/ditë.
--	--	--	--	-----------------

III.2.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, gjykojmë, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.2.8. Në lidhje me pretendimin e ankimuesit për disponimin e lejes me kodin III.1.B (Magazinin i mbetjeve), Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se sipas kriterit të kualifikimit është kërkuar leje me kodin III.1.B (magazinin mbetjesh) dhe për përmbushjen e të cilës operatori ekonomik “Infinit” SHPK ka dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), dokumentin Leje me kodin III.1.B në emër të subjektit “Infinit” SHPK. Referuar ligjit nr. 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar i cili ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës dhe sipas po këtij ligji, subjektet private pajisen me “Leje mjedisi tipi B” e përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe e firmosur nga ministri, e cila lëshohet nga QKL-ja, që i jep të drejtën e funksionimit, tërësisht ose pjesërisht, instalimit të tipit B, sipas përcaktimit të këtij ligji dhe që përmban të shkruara kushtet e nevojshme për të garantuar, se instalimi përmbush kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi. Leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1 të këtij ligji.

Nga shqyrtimi i dokumentit me emërtimin “Leje” me kodin III.1.B të lëshuar në emër të shoqërisë “Infinit” SHPK, me numër PN-0366-04-2021, shoqëruar me akt-miratimi Leje Mjedisi tipi B me nr. 2611 prot., datë 14.04.2021 të miratuar nga Ministri i Turizimit dhe Mjedisit, Komisioni Prokurimit Publik konstaton, se referuar pikave 2.1 Titullit të instalimit: Menaxhimi i mbetjeve dhe pikës 2.2. Përshkrimi i veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues: I.D.5.4/c Rikuperim i mbetjeve jo të rrezikshme, ky përshkrim veprimtarie nuk plotëson kriterin e kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e tenderit, të hartuara nga autoriteti kontraktor. Sipas kriterit të kualifikimit është kërkuar leje me kodin III.1.B me përshkrim të veprimtarisë “magazinin

mbetjesh” ndërsa sipas dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Infinit” SHPK rezulton se është dorëzuar leje me emërtimin “Rikuperim i mbetjeve jo të rrezikshme” pra një veprimtari e ndryshme nga ajo që është kërkuar në kriterin e veçantë të kualifikimit.

Gjithashtu, nga verifikimi në Ekstraktin e Regjistrimit Tregtar për të dhënat e operatorit ekonomik “Infinit” SHPK, Komisioni konstatoi se, objekti i aktivitetit është *grumbullim, transport dhe riciklim i mbetjeve jo të rrezikshme* dhe jo sipas veprimtarisë së kërkuar në kriterin e veçantë të kualifikimit. Për më tepër, operatori ekonomik “Infinit” SHPK, në argumentet (kleime) që ka dërguar me shkresën nr. 1281/3 prot., datë 13.07.2021 në KPP, nuk ka sjellë asnjë dokumentacion provues apo argument në lidhje me disponimin e lejes me kodin III.1.B me përshkrim veprimtarie magazinim mbetjesh.

Neni 92 pika 3 e LPP-së parashikon se “*Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.*”. Në rastin konkret, Komisioni gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Infinit”SHPK në procedurën e prokurimit, nuk i plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor dhe nuk konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “*Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-95477-05-14-2021, me objekt: “*Rehabilitim i Rrugës së Rrodokalit, Njësia administrative Proptisht*”, me fond limit 58,333,330 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 08.06.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Infinit” SHPK & “Sireta 2 F” SHPK, duke e skualifikuar këtë bashkim operatorësh ekonomikë.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Rej” SHPK.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	Anila Malaj	Kreshnik Ternova
	Kryetar	
	Jonaid Myzyri	